



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA E PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 7522/Prot.
11

Tiranë, më 24.08. 2019

NJOFTIM

**Për shprehjen e interesit për të marrë pjesë në Tryezën e Partneritetit për
Kapitullin 5: Prokurimi Publik**

Në vijim të VKM nr. 749, datë 19.12.2018 “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e strukturës shtetërore përgjegjëse, për zhvillimin e negociatave dhe lidhjen e Traktatit të Aderimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian” dhe Urdhrit të kryeministrit nr. 113, datë 30.08.2019, “Për format e pjesëmarrjes, funksionimin dhe strukturën institucionale të platformës së partneritetit për Integrimin Evropian”, ftojmë paraqitjen e kandidaturave për të marrë pjesë në Tryezën e Partneritetit për Kapitullin 5 të acquis: Prokurimi Publik, kryesuar nga Agjencia e Prokurimit Publik.

Qëllimi i Tryezave të Partneritetit është të diskutojë, të shqyrtojë dhe të ndërmarrë qëndrime dhe rekomandime drejtuar institucioneve, Sekretariatit të Integritetit Evropian dhe Strukturave të tjera përgjegjëse për integrimin evropian për çështjet dhe fushat specifike që mbulojnë si edhe të këshillohen në lidhje me programimin, zbatimin, monitorimin dhe vlerësimin e asistencës së Bashkimit Evropian për Shqipërinë.

Personat e interesuar për të qenë pjesë e Tryezës së Prokurimit Publik duhet të jenë përfaqësues të grupeve të mëposhtme:

1. Organizatave të shoqërisë civile;
2. Pushtetit vendor;
3. Komunitetit të biznesit;
4. Shoqatave të punëmarrësve;
5. Botës akademike;
6. Medias;
7. Grupeve të interesit.

Personat e interesuar, janë të lutur të dërgojnë pranë APP, në adresën e e-mailit info.app@app.gov.al duke specifikuar në subjekt **Tryeza e Partneritetit, një Letër Interesi dhe**

një CV të tyre apo grupimit që përfaqësojnë, ku të tregojnë ekspertizën apo interesin e mjaftueshëm për të kontribuar në Tryezën e Partneritetit për Prokurimin Publik, brenda datës 30 Shtator 2019.

Në përfundim të procesit do të përzgjidhen nga dy përfaqësues për secilën kategori të përmendur më sipër.

Personat e përzgjedhur do të njoftohen me e-mail brenda datës 07 Tetor 2019. Gjithashtu, personat e skualifikuar do të njoftohen me e-mail për arsyet e skualifikimit.

Duke ju falënderuar,

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

